

# Aksidentet Rrugore

## Prill 2019

**Tiranë, më 21 Maj 2019:** Në muajin Prill 2019 numërohen 112 aksidente rrugore nga 134 aksidente të ndodhura në Prill 2018, duke u ulur me 16,4 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Fig. 1 Aksidentet rrugore mujore, Prill 2015 – Prill 2019



Në Prill 2019, numri i të aksidentuarve (të vrarë dhe të plagosur) është 147 persona nga 168 që ishte një vit më parë, duke u ulur me 12,5 %. Numri i të aksidentuarve në katërmujorin e parë të vitit 2019, është 630 persona nga 651 persona duke u ulur me 3,2 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të 2018..

Në muajin Prill 2019, numri i të vdekurve nga aksidentet rrugore është 14 persona duke mbetur i pandryshuar, krahasuar me Prill 2018. Në katërmujorin e parë 2019, numri i të vdekurve nga aksidentet rrugore është 62 nga 61 që ishte një vit më parë.

Në Prill 2019, aksidentet rrugore, në 84,8 % të rasteve, kanë ndodhur si pasojë e sjelljes së drejtuesit të mjetit. Numri më i lartë i aksidenteve në këtë periudhë është kryer nga grup mosha 25 –35 vjeç, duke zënë 33,9 % të numrit të aksidenteve gjithsej. Aksidentet në këtë grup moshe janë ulur me 17,4 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Në katërmujorin e parë 2019, aksidentet rrugore, në 16,0 % të rasteve, kanë ndodhur si pasojë e sjelljes së këmbësorit. Gjatë kësaj periudhe, numri i aksidenteve sipas sjelljes së këmbësorit është ulur 25,0 %, krahasuar me një vit më parë.

**Për publikim 21/05/2019**

**Tab. 1 Aksidentet rugore**

Periudha	Aksidente Gjithsej	Të vdekur		Të plagosur	
		Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj
Prill-2018	134	4	10	41	113
Prill-2019	112	3	11	36	97
Ndryshimi vjetor (%)	<b>-16,4</b>	<b>-25,0</b>	<b>10,0</b>	<b>-12,2</b>	<b>-14,2</b>
Janar–Prill 2018	504	13	48	174	416
Janar–Prill 2019	468	19	43	167	401
Ndryshimi vjetor progresiv(%)	<b>-7,1</b>	<b>46,2</b>	<b>-10,4</b>	<b>-4,0</b>	<b>-3,6</b>

**Tab. 2 Aksidentet rugore, sipas përdoruesve të rugës**

Periudha	Aksidente sipas		Të vdekur	
	Sjellja e Drejtuesit të Mjetit	Sjellja e Këmbësorëve	Sjellja e Drejtuesit të Mjetit	Sjellja e Këmbësorëve
Prill-2018	114	20	14	0
Prill-2019	95	17	13	1
Ndryshimi vjetor (%)	<b>-16,7</b>	<b>-15,0</b>	<b>-7,1</b>	<b>-</b>
Janar –Prill 2018	404	100	50	11
Janar –Prill 2019	393	75	57	5
<b>Ndryshimi vjetor progresiv (%)</b>	<b>-2,7</b>	<b>-25,0</b>	<b>14,0</b>	<b>-54,5</b>

**Tab. 3 Aksidentet rugore, sipas moshës së drejtuesit të mjetit**

Periudha	Moshë					Larguar nga vendi i ngjarjes
	0 - 25 vjeç	25- 35 vjeç	35- 45 vjeç	45-60 vjeç	60+ vjeç	
Prill-2018	24	46	25	19	15	5
Prill-2019	20	38	19	24	6	5
<b>Ndryshimi vjetor (%)</b>	<b>-16,7</b>	<b>-17,4</b>	<b>-24,0</b>	<b>26,3</b>	<b>-60,0</b>	<b>0,0</b>
Janar–Prill 2018	99	147	92	95	38	33
Janar–Prill 2019	100	136	90	88	33	21
<b>Ndryshimi vjetor progresiv (%)</b>	<b>1,0</b>	<b>-7,5</b>	<b>-2,2</b>	<b>-7,4</b>	<b>-13,2</b>	<b>-36,4</b>

**Tab. 4 Aksidentet rrugore sipas qarqeve**

Periodha	Aksidente		Të vdekur		Aksidente		Të vdekur	
	Prill-2018	Prill-2019	Prill 2018	Prill-2019	Janar – Prill 2018	Janar – Prill 2019	Janar – Prill 2018	Janar - Prill 2019
<b>Shqipëria</b>	134	112	14	14	504	468	61	62
Tiranë	60	51	3	3	230	204	14	9
Durrës	20	13	1	2	77	46	9	10
Shkodër	2	3	2	3	10	9	11	8
Elbasan	6	7	1	3	29	26	8	8
Fier	12	5	5	0	25	34	7	8
Vlorë	6	5	0	0	29	27	1	3
Korçë	10	7	1	2	19	25	1	4
Lezhë	13	9	0	0	48	51	2	3
Berat	2	2	0	0	14	9	1	2
Kukës	2	3	1	0	6	11	3	1
Diber	0	1	0	0	8	5	3	4
Gjirokastër	1	6	0	1	9	21	1	2

# Përkufizime

**Aksidente:** Aksidentet rrugore që ndodhin tek një ose më shumë persona që goditen nga mjetet e qarkullimit rrugor.

**I vdekur:** I vdekur nga aksidenti në rrugë quhet çdo person i cili ka vdekur menjëherë ose brenda 30 ditëve si rezultat i aksidentit.

**I plagosur:** I plagosur konsiderohet çdo person, i cili nuk ka vdekur por ka marrë plagë të lehta apo të rënda si rezultat i aksidentit.

**Sjellja e Drejtuesit të Mjetit :** Nënkupton nëse drejtuesi i mjetit nuk zbaton rregullat e qarkullimit rrugor sipas “Kodit Rrugor” si: frenim i papritur, mosrespektimi i shenjave (sinjalistikës) së trafikut, mosrespektimi i normave të shpejtësisë, etj.

**Sjellja e Këmbësorëve:** Nënkupton nëse këmbësori nuk zbaton rregullat e qarkullimit rrugor sipas “Kodit Rrugor” si : kalim rruge pa kujdes, etj.

**Burimi i të dhënave:** Të dhënat janë siguruar nga Ministria e Punëve të Brendshme/Drejtoria e Policisë së Shtetit.

*Të dhënat e muajit të fundit mbi Personat e vdekur nga aksidentet rrugore janë paraprake dhe subjekt rishikimi.Për më shumë, referohu: <http://www.instat.gov.al/rreth-nesh/cilesia-statistikore.aspx/> Politika e revizionimit statistikor.*